

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Kryesia e Kuvendit
Mbledhja nr. **02-76/26-07**
Prishtinë, më 25 tetor 2007, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur
më 25 tetor 2007

Në mbledhje morën pjesë: Kolë Berisha, kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë:
Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Ramë Buja, Naim Maloku, Gazmend Muhaxheri dhe Bislim
Hoti.

Nga grupet parlamentare: Alush Gashi, Ramdadan Kelmendi dhe Mahir Yagcilar.

Në mbledhje ishin të pranishëm: nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut
Beqiri, Xheladin Hoxha, Thëllenza Arifi dhe Sherif Konjufca;

Nga: Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Skënder Durmishi;

Nga: ZKM-ja Shefik Kurtishi;

Nga: Projekti për Mbështetje të Mëtejme Kuvendit, Hugues Courtivron;

Nga: NDI-ji Dale Archer dhe

Nga: OSBE-ja Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Kolë BERISHA**, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit për rendin e ditës dhe për materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia miratoi propozimin e rendit të ditës.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R E N D I T E:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë të 18 tetorit 2007;
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës dhe
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i propozimeve.

Kryetari i informoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare me materialet e përgatitura për shqyrtim në seancën plenare të radhës dhe kërkoi pëlqimin e tyre për secilën pikë të rendit të ditës.

Kryetarët e grupeve parlamentare (të pranishëm në mbledhje) u pajtuan me propozimin e pikave të rendit të ditës për seancën e radhës, si dhe për datën e mbajtjes së saj më **30 tetor 2007**.

Sabri Hamiti propozoi që Kryesia, në bazë të rregullës 61 të Rregullores së punës të Kuvendit, t'i rekomandojë Kuvendit që të marrë vendim për shmangie të përkohshme nga rregulla 5.2 e Rregullores së punës.

Ai propozimin e arsyetoi se Kuvendi, sipas Rregullores së punës, pezullon punën nga dita e fillimit të fushatës zgjedhore. Ekipi i Unitetit ka marrë qëndrim politik që Kuvendi do të punojë deri para zgjedhjeve, të cilin e ka mbështetur edhe PSSP-ja, z.Ruecker. Prandaj, duhet krijuar bazë legale për vazhdimin e punës së Kuvendit edhe në kohën e fushatës zgjedhore.

Kryesia mbështeti propozimin e Sabri Hamitit që t'i rekomandojë Kuvendit, në seancën plenare të radhës, të marrë vendim për shmangie të përkohshme nga rregulla 5.2 të Rregullores së punës.

Pas kësaj kohe, Kryesia i zhvilloi punimet pa praninë e kryetarëve të grupeve parlamentare.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë të 11 tetorit 2007

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë të 11 tetorit 2007 u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë, veç e veç, vendosi që Kuvendit t'ia propozojë rendin e ditës për seancën plenare më **30 tetor 2007**, si vijon:

1. Shqyrtimi i Propozimit për shmangie të rregullës 5.2 të Rregullores së punës,
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 18 tetorit 2007,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Debat lidhur me ofertën e Grupit Negociator për Traktatin e Miqësisë dhe të Bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të PDK-së,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për hetim parlamentar,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dokumentet e udhëtimit,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësit e deputetit,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore,
11. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport lidhur me Projektligjin për arsimin dhe aftësimin privat,
12. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për emërimin e Avokatit të Popullit,
13. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Kosovës për trashëgiminë kulturore dhe
14. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për kthim në ripunim të Projektligjit për punë, të Projektligjit për grevat dhe të Projektligjit për organizimin sindikal.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i propozimeve

- 3.1 Shqyrtimi i propozimit të Grupit Parlamentar të PDK-së për të debatuar në seancën e radhës lidhur me ofertën e Grupit Negociator për Traktatin e Miqësisë dhe të Bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-së, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Mbështet kërkesa e Grupit Parlamentar të PDK-së për të debatuar, në seancën plenare të 30 tetorit 2007, për ofertën e Grupit Negociator për Traktatin e Miqësisë dhe të Bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe lidhur me këtë të njoftohet Grupi Negociator.

3.2. Shqyrtimi i Propozim - Rregullores së Kryesisë të Kuvendit

Kryesia, pasi shqyrtoi Propozim - Rregulloren e Kryesisë të Kuvendit, vendosi që miratimin e saj ta shtyjë për mbledhjen e radhës.

3.3 Shqyrtimi i Raportit financiar të tremujorit të tretë për 2007 (Pikë shtesë)

Kryesia shtyu shqyrtimin e Raportit financiar të tremujorit të tretë për vitit 2007 për mbledhjen e ardhshme.

Kryetari mbledhjen e deklaroi të mbyllur në orën 11: 10 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë BERISHA

E hartoi:

Divizioni i Çështjeve Plenare e Procedurale